



# Kolegji AAB

Rr. "Elez Berisha", nr. 56, Zona  
Industriale Prishtinë-Fushë Kosovë,  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës,  
Tel: +383 38 600 005; +383 45 284 797  
Mail: [info@aab-edu.net](mailto:info@aab-edu.net);  
[www.aab-edu.net](http://www.aab-edu.net)

Ref. nr. 620 /2021 Prishtinë, 30.08.2021

Në bazë të nenit 29 dhe 33 të Statutit dhe nenit 4 të Rregullores së Punës të Këshillit Drejtues, Këshilli Drejtues merr këtë:

## V E N D I M

- I. Themelohet **Qendra për Aftësim Profesional dhe Inovacion** e Kolegjit AAB.
- II. Detyrat dhe përgjegjësitë, fushëveprimtaria, stafi i qendrës dhe çështje tjera me rëndësi për funksionimin e kësaj qendre do të parashihen me Rregulloren e Punës të Qendrës për Aftësim Profesional dhe Inovacion e cila do të miratohet nga Këshilli Drejtues.
- III. Zyra për Marrëdhënie me Publikun kujdeset që qendra të ketë hapësirën e vet në kuadër të web faqes së Kolegjit AAB.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## A r s y e t i m

Qendra për Aftësim Profesional dhe inovacion e Kolegjit AAB themelohet me qëllim të ofrimit të shërbimeve të certifikuara të aftësimin dhe përkrahjes profesionale për personelin akademik dhe administrativ në AAB (përfshirë personelin e British School of Kosova dhe të njësive të tjera vartëse të AAB) dhe në institucionet e tjera të arsimit të lartë në Kosovë në funksion të ndërtimit të kapaciteteve akademike dhe ngritjes së cilësisë së mësimdhënies, hulumtimit dhe të menaxhimit.

Këshilli Drejtues duke vlerësuar rëndësinë e themelimit të një qendre të tillë, dhe pasi vlerësoi projektin për themelimin e kësaj qendre, vendosi si në dispozitiv të vendimit.

Vendimi iu dorëzohet:

1. Rektorit
2. Dekanëve të Fakulteteve
3. Zyres për Marrëdhënie me Publikun
4. Arkivit



Prof.ass.dr. Lulzim Tafa  
Kryetar i Këshillit Drejtues